



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 341 prot

Elbasan, më 12.02.2022

VENDIM

Nr 03 datë 12.02.2022

Për

trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2021-2022

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", e ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit miratimit të kërkesave online për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022, Vendimeve të Bordit të Administrimit nr 38 datë 02.11.2021 "Për procedurën e aplikimit të studentëve në Ciklin e parë të studimit për bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit per vitin 2021-2022", Relacionit të Administratorit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2021-2022" për studentët e shkëlqyer dhe në nevojë, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Të përfitojnë bursë financiare 141 studentë me rezultate, që vazhdojnë studimet në Ciklin e parë të studimeve, me program të parë studimi, si edhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 2- Të përfitojnë bursë financiare 1,150 studentë me kriterë të tjera, nga data e fillimit të vitit akademik 2021-2022, mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1,310 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 4- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 48 studentë, sipas listës bashkëlidhur.
- 5- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin, apo të mosplotësimit të kriterëve të studentëve sipas listës në pikën 1, 2 dhe 3, të mos zbatohet vendimarrja e



përfitimit, ndërsa ndryshimet në rastet e përfitimit të listës së pikës 4 të paraqiten për vendimarrje në BA.

- 6- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI**

